



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2700/19 prot.

Datë 14.02.2024

V E N D I M
Nr. 173/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.02.2024 mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 82/2024 , datë 24.01.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, “Identitek” Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10.
- Autoriteti Kontraktor:** “Identitek” Sh.A
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Nd.1. Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Librari “Dyrrahu” SHPK me NIPT L91418502J dhe adresë Durrës, Rruga Egnatia/3, Godina 1039, Zona Kadastrale Nr. 8514, Volumi 38, Faqe 125, Numri i Pasurisë 4/162-N1
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1 Në datë 24.01.2024 , Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.82/2024 , ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20- 2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing& Distriburion” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 125/38 prot., datë 12.02.2024 , protokolluar me tonën nr. 2700/16 prot., datë 13.02.2024 , autoriteti kontraktor , Identitek Sh.A. informon me shkresën me objekt : “Mbi zbatimin te Vendimit Nr 142/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, per procedurën e prokurimit me objekt “Blerje material Kancelarie”. Ku citon se [...] *Bashkëlidhur po ju ergushme –Proces-Vrbal nr 4. Datë 12.02.2024 “ mbi ri-vlersimin e ofertave”*[...].

I.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik për procedurën e prokurimit me nr REF-80585-09-20-2023 KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersim për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 125/38 prot., datë 12.02.2024 , protokolluar me tonën nr. 2700/16 prot., datë 13.02.2024 , autoriteti kontraktor , Identitek Sh.A. informon me shkresën me objekt : “Mbi zbatimin te Vendimit Nr 142/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, per procedurën e prokurimit me objekt “Blerje material Kancelarie”. Ku citon se [...] *Bashkëlidhur po ju ergushme –Proces-Vrbal nr 4. Datë 12.02.2024 “ mbi ri-vlersimin e ofertave”*[...].

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik për procedurën e prokurimit me nr REF-80585-09-20-2023 KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersim për procedurën e prokurimit objekt ankimi

II.3. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersim, dhe ka zbatuar vendimin e Komisionit Prokurimit Publik Nr. 82/2024 datë 24.01.2024.

Referuar raportit të auditit të kësaj procedure prokurimi operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK është me statusin i refuzuar.

II.3 Sa më sipër, autoriteti kontraktor Identitek Sh.A ka zbatuar vendimin Nr. 82/2024 datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 12.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*“E hapur, e thjeshtuar”*”, me Nr. REF-75647-07-20-2023, me objekt: “*Blerje Materiale Kancelarie*”, me fond limit 4,981,157.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor, “Identitek” Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

